

**AGJENCIA KOMBËTARE  
E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT**Nr. 2003/1 Prot, Datë 24.04 .2020**DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E TATIMEVE**Nr. 7017/1 Prot, Datë 24.4 .2020**RREGULLORE E PËRBASHKËT****PËR****SAKTËSIMIN E PROCEDURAVE PËR CERTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E  
PRODHUESVE DHE MIRËMBAJTËSVE TË ZGJIDHJEVE SOFTWARE-IKE**

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.239, datë 20.3.2020 “Për kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes software-ike për procedurën e faturimit dhe të fiskalizimit si dhe procedurën e kriteret për regjistrimin e prodhuesve e të mirëmbajtësve të zgjidhjeve software-ike”, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përcaktojnë rregullat, afatet dhe procedurat për certifikimin dhe regjistrimin e prodhuesve dhe mirëmbajtësve të zgjidhjeve software-ike, në këtë Rregullore të Përbashkët si më poshtë vijon:

1. AKSHI dhe DPT-ja, me urdhër të përbashkët, do të ngrenë një komision të përhershëm, me specialistë sipas fushave të përkatësisë. Komisioni do të udhëhiqet nga dy bashkëkryetarë, dhe do të shqyrtojë kërkesat e çdo aplikanti, të dhënat dhe dokumentacionin e paraqitur si dhe vetë zgjidhjen e software-it.
2. Pjesë e komisionit do të jetë edhe Sekretariati Teknik, që do të angazhohet për njoftimin dhe organizimin e mbledhjeve të Komisionit, mbajtjen dhe administrimin e minutave të takimit etj.
3. Sekretariati Teknik njofton bashkëkryetarët e komisionit sa herë që ka aplikime të reja dhe njofton të gjithë anëtarët për datën dhe orën e takimit të propozuar nga bashkëkryetarët. Çdo kërkesë duhet të shqyrtohet jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune pasi është kryer aplikimi.
4. Në mbledhjet e Komisionit duhet të marrin pjesë minimalisht më tepër se 50% e anëtarëve të Komisionit. Nëse nuk plotësohet kuorumi i nevojshëm, mbledhja shtyhet, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune. Prezenca në mbledhje e të paktën një bashkëkryetari është e detyrueshme.



5. Komisioni shqyrton dhe vendos për çdo aplikim bazuar në kërkesat dhe kriteret e mirëpërcaktuara në VKM nr.239, datë 20.3.2020 "Për kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes software-ike për procedurën e faturimit dhe të fiskalizimit si dhe procedurën e kriteret për regjistrimin e prodhuesve e të mirëmbajtësve të zgjidhjeve software-ike".

6. Në rast se, aplikimi është i paplotë, Komisioni kërkon nga aplikanti plotësimin e aplikimit me dokumentacionin shtesë të nevojshëm jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune.

7. Komisioni harton një rregullore për saktësimin e procedurave teknike të testimit të zgjidhjes software-ike.

8. Në rast se, për një aplikim ka diskutime apo paqartësi lidhur me vlefshmërinë e dokumentacionit të paraqitur apo të vetë zgjidhjes software-ike, Komisioni mund të shtyjë dhe të vendosë rishqyrtimin e aplikimit në mbledhjen e ardhshme, e cila duhet të mbahet jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune.

9. Vendimarrja e Komisionit duhet të jetë konsensuale. Nëse, për raste të caktuara nuk arrihet konsensusi i nevojshëm, vendimarrja merret bazuar në votat e çdo anëtari. Në rastet kur nuk arrihet kuota mbi 50 %, prevalon vota e bashkëkryetarëve. Nëse edhe bashkëkryetarët kanë qëndrime të kundërta, atëherë rasti diskutohet nga bashkëkryetarët me titullarët e institucioneve respektive për të dalë me një vendimarrje konsensuale.

10. Në fund të çdo takimi, Komisioni duhet të dalë me Vendim, ku sugjeron që AKSHI dhe DPT-ja të lëshojnë certifikatën e regjistrimit për aplikimin e shqyrtuar ose të vendosin refuzimin e kërkesës. Në të dyja rastet, Vendimet e Komisionit shoqërohen edhe me një relacion sqarues për çdo aplikim. Pjese e relacionit janë edhe mendimet kundër nëse ka. Vendimet e Komisionit nënshkruhen nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.

11. Komisioni është përgjegjës edhe për trajtimin e çdo informacioni dhe/apo dokumentacioni provues të përcjellë për trajtim nga DPT apo AKSHI, në rastet e konstatimit të shkeljeve të akteve ligjore apo nënligjore nga ana e prodhuesve apo mirëmbajtësve të zgjidhjeve software-ike të regjistruar.

12. Shkeljet e konstatuara trajtohen brenda të njëjtave afate dhe me të njëjtën procedure si edhe aplikimet për regjistrim. Pas vlerësimit të praktikës, Komisioni harton një relacion sqarues, ku sugjeron që, AKSHI dhe DPT-ja të vendosin ta shfuqëzojnë ose jo certifikatën e dhënë.

13. Certifikata e regjistrimit në regjistrin e prodhuesve ose të mirëmbajtësve software-ike lëshohet nga AKSHI dhe DPT të cilët bashkërisht kanë të gjitha të drejtat mbi të. Certifikata lëshohet nëpërmjet portalit e-Albania. Certifikata do të përmbajë edhe kodin e prodhuesit/mirëmbajtësit të zgjidhjes së software-it dhe kodin e zgjidhjes së software-it të regjistruar. Format i miratuar i certifikatës do të jetë ai sipas modelit të aneksit 1, bashkëlidhur kësaj rregullore.





14. AKSHI administron regjistrin e prodhuesve ose të mirëmbajtësve software-ike, i cili do të jetë publik dhe mund të aksesohet lehtësisht në faqen zyrtare të internetit të AKSHI-t. Regjistri ka dhe një aneks të veçantë ku regjistrohen Vendimet për shfuqizimin e certifikatës.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Mirlinda KARCANAJ**



**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Delina IBRAHIMAJ**

